



PROVIMI I MATERIËS SHTETËRORE 2023
ME ZGJEDHJE – SESIONI I
SKEMA E VLERËSIMIT

LËNDA: FIZIKË

Varianti B

Shënim:

- Vlerësuesit e testeve janë trajnuar, që të vlerësojnë çdo përpjekje të nxënësit dhe të jenë të kujdeshëm, sidomos në pyetjet me zhvillim dhe arsyetim, që kanë më shumë se një mundësi zgjidhjeje.
- Çdo zgjidhje e dhënë nga nxënësit ndryshtë nga skema e vlerësimit, por që komisioni i vlerësimit e gjykon si të saktë, do të marrë pikët përkatëse.
- Përgjigjet e sakta për pyetjet me alternativa vlerësohen me 1 pikë.

Përgjigjet e sakta për pyetjet me alternativa

Pyetja	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Alternativa e saktë	C	B	A	C	A	A	C	A	D	C
Pyetja	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20
Alternativa e saktë	B	C	D	D	B	B	C	A	B	D

Pyetjet me zhvillim dhe arsyetim

Pyetja 21 2 pikë


Përgjigje:

Guri ngjitet deri në pikën më të lartë (h_{\max}) me lëvizje drejtvizore njëtrajtësisht të ngadalësuar, zbat deri në nivelin fillestar (maja e shkëmbit) dhe pastaj vazhdon rënien deri sa prek tokën. $I = 2h_{\max} + H$ (1)

Në formulën $v^2 - v_0^2 = 2gh$ kur trupi arrin në pikën më të lartë të ngjitjes $v = 0$ kemi:

$$-v_0^2 = -2gh_{\max} \text{ nga ku: } h_{\max} = \frac{v_0^2}{2g} = 20m.$$

Duke zëvendësuar vlerat e gjetura në ekuacionin (1) marrim $I = 120m$.



- 2 pikë** Nëse nxënësi gjen lartësinë maksimale të ngjitjes dhe rrugën e plotë të përshkruar nga guri.
- 1 pikë** Nëse nxënësi gjen vetëm lartësinë maksimale të ngjitjes **OSE** tregon trajektoren që ka përshkruar guri.
- 0 pikë** Nëse nxënësi e ka zgjidhur në mënyrë të gabuar **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen.


Pyetja 22**3 pikë****Përgjigje:**

Lëvizja që kryen makina gjatë frenimit është lëvizje drejtvizore njëtrajtësisht e ngadalësuar me nxitim konstant $a = -10 \text{ m/s}^2$, $v_0 = 36 \text{ km/h} = 10 \text{ m/s}$ dhe meqenëse ndalon $v = 0$.

a) Zëvendësojmë të dhënrat në: $v^2 - v_0^2 = 2ax$ dhe gjejmë $x=5\text{m}$

b) Koha për të cilën makina ka frenuar $v = v_0 + at$ ku $t = \frac{v - v_0}{a} = 1\text{s}$

c) Në grafikun $v(t)$ caktojmë $v_0 = 10\text{m/s}$ në $t_0 = 0$ dhe $v = 0$ në $t_1 = 1\text{s}$



3 pikë Nëse nxënësi gjen largësinë e përshkruar deri në ndalim ,kohën e ndalimit dhe ndërtuan grafikun shpejtësi-kohë.

2 pikë Nëse nxënësi gjen largësinë e përshkruar deri në ndalim dhe kohën e ndalimit **OSE** gjen kohën e ndalimit dhe ka ndërtuar grafikun.

1 pikë Nëse nxënësi gjen vetëm largësinë e përshkruar deri në ndalim **OSE** kohën e ndalimit.

0 pikë Nëse nxënësi e ka zgjidhur në mënyrë të gabuar **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen.

Pyetja 23**4 pikë****Përgjigje:**


Vizatojmë forcat në figurë.

Zbatojmë ligjin e parë të Njutonit për trupin: $\vec{F}_x + \vec{F}_y + \vec{N} + \vec{G} + \vec{F}_f = 0$

Projektojmë sipas ox : $F_x - F_f = 0$ (1) ku $F_f = \mu N$
sipas oy: $N + F_y - G = 0$ (2)

Në ekuacionin (2) zëvendësojmë vlerat për $G = m \cdot g$; $F_y = F \cdot \sin 30^\circ$ dhe gjejmë $N = 90\text{N}$.

Nga ekuacionin (1) $F_x = \mu N$ sjell $\mu = \frac{F_x}{N}$ zëvendësojmë $F_x = F \cdot \cos 30^\circ$ dhe gjejmë $\mu = 0.1$



4 pikë Nëse nxënësi gjen vlerën për forcën e kundërveprimt dhe të koeficientit të fërkimit.

3 pikë Nëse nxënësi ka vizatuar forcat, ka zbatuar ligjin e parë të Njutonit dhe ka gjetur forcën e kundërveprimt **OSE** ka vizatuar forcat, ka zbatuar ligjin e parë të Njutonit dhe ka gjetur koeficientin e fërkimit.

2 pikë Nëse nxënësi vizaton forcat në figurë dhe zbaton ligjin e parë të Njutonit.

1 pikë Nëse nxënësi vizaton forcat në figurë.

0 pikë Nëse nxënësi e ka zgjidhur në mënyrë të gabuar **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen.

Pyetja 24**2 pikë****Përgjigje:**

Nga figura identifikojmë impulset për secilën karrocë.


Impulsi i sistemit para goditjes: $\vec{p}_s = \vec{p}_X + \vec{p}_Y$ ose i projektuar sipas ox: $p_s = p_x - p_y$ gjemë $p_s = 8 \text{ kg m/s}$

Zbatojmë ligjin e ruajtjes së impulsit $\vec{p}_s = \vec{p}_s$ ku $p_Y = 10 \text{ kg m/s}$ dhe gjemë $p_X = 2 \text{ kg m/s}$

2 pikë Nëse nxënësi gjen impulsin e sistemit para goditjes dhe impulsin e karrocës X pas goditjes.

1 pikë Nëse nxënësi gjen impulsin e sistemit para goditjes **OSE** impulsin e karrocës X pas goditjes.

0 pikë Nëse nxënësi e ka zgjidhur në mënyrë të gabuar **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen.

Pyetja 25**3 pikë****Përgjigje:**

Zbatojmë ligjin e ruajtjes dhe shndërrimit të energjisë në mungesë të fërkimit për sistemin sustë-trup nga gjendja

$$(1)\text{në }(2): E_{M_1} = E_{M_2} \text{ ose } E_{p_{e_1}} = E_{k_2} \quad \frac{kx^2}{2} = \frac{mv^2}{2} \text{ duke zëvendësuar gjemë } v = 4 \text{ m/s}$$

Zbatojmë teoremën e energjisë kinetike nga gjendja (2) në (3). $E_{k_3} - E_{k_2} = A_f \quad E_{k_3} = 0 \text{ gjemë } A_{ff} = -4J$

Gjemë zhvendosjen e trupit deri sa ndalon: $-A_{ff} = -\mu mgx$ nga ku: $x = 8 \text{ m}$

3 pikë Nëse nxënësi gjen shpejtësinë e trupit kur shkëputet nga susta, punën e forcës së fërkimit dhe zhvendosjen e trupit derisa ndalon.

2 pikë Nëse nxënësi gjen shpejtësinë e trupit kur shkëputet nga susta dhe zhvendosjen e trupit derisa ndalon **OSE** shpejtësinë e trupit kur shkëputet nga susta dhe punën e forcës së fërkimit.

1 pikë Nëse nxënësi gjen shpejtësinë e trupit kur shkëputet nga susta.

0 pikë Nëse nxënësi e ka zgjidhur në mënyrë të gabuar **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen

Pyetja 26**2 pikë****Përgjigje e plotë:**

Zbatojmë ligjin e ruajtjes dhe shndërrimit të energjisë në mungesë të fërkimit për trupin: $E_{M_1} = E_{M_2}$


$$E_{p_1} = E_{k_2} \text{ dhe gjen } v_2 = 10 \text{ m/s}.$$

$$\text{Duke ditur se: } \Delta E_{pg} = mg\Delta h \text{ gjemë } \Delta E_{pg} = 100J.$$

2 pikë Nëse nxënësi gjen shpejtësinë e bllokut në fund të rrafshit të pjerrët dhe ndryshimin e energjisë potenciale gravitacionale të tij.

1 pikë Nëse nxënësi gjen shpejtësinë e bllokut në fund të rrafshit të pjerrët **OSE** ndryshimin e energjisë potenciale gravitacionale të tij.

0 pikë Nëse nxënësi e ka zgjidhur në mënyrë të gabuar **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen.



Pyetja 27**3 pikë****Përgjigje:**

Identifikojmë nga grafiku se gazi kryen proces izobarik $P=\text{konstante}$. Nxjerrim të dhënrat nga grafiku.

Nga formula e procesit izobarik $\frac{V_A}{T_A} = \frac{V_B}{T_B}$ përcaktojmë $T_B = 900\text{K}$

Gjejmë punën e kryer nga gazi $A = p(V_B - V_A)$ $A=1200\text{J}$

Nga parimi i parë i termodinamikës $Q=A+\Delta U$ $\Delta U=800\text{J}$

3 pikë Nëse nxënësi gjen temperaturën e gazit në fund të procesit, punën që ai kryen dhe ndryshimin e energjisë së brendshme të tij.

2 pikë Nëse nxënësi gjen temperaturën e gazit në fund të procesit dhe punën që ai kryen.


1 pikë Nëse nxënësi gjen temperaturën e gazit në fund të procesit **OSE** punën që ai kryen.

0 pikë Nëse nxënësi e ka zgjidhur në mënyrë të gabuar **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen.

Pyetja 28**4 pikë****Përgjigje:**

Vizatojmë vijat e intensitetit të fushës elektrike.

Përcaktojmë U me formulën: $E = \frac{U}{d}$ nga ku: $U=9\text{V}$



Vizatojmë forcat mbi ngarkesën, gjejmë $G=mg$ dhe $F_e=Eq$ dhe me formulën $T = G + F_e$ gjejmë $T=1\text{N}$

4 pikë Nëse nxënësi vizaton vijat e intensitetit të fushës elektrike, gjen diferençën e potencialit, forcën e fushës elektrike dhe forcën e tensionit të fijes.

3 pikë Nëse nxënësi vizaton vijat e intensitetit të fushës elektrike, gjen diferençën e potencialit, forcën e fushës elektrike dhe ka vizatuar forcat mbi ngarkesë.

2 pikë Nëse nxënësi vizaton vijat e intensitetit të fushës elektrike, gjen diferençën e potencialit **OSE** vizaton vijat e intensitetit të fushës elektrike dhe forcat mbi ngarkesë.

1 pikë Nëse nxënësi vizaton vijat e intensitetit të fushës elektrike **OSE** gjen diferençën e potencialit **OSE** vizaton forcat mbi ngarkesë **OSE** gjen forcën e fushës elektrike.

0 pikë Nëse nxënësi e ka zgjidhur në mënyrë të gabuar **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen.

Pyetja 29**2 pikë****Përgjigje:**

Përcaktojmë ngarkesën që kalon në përcjellës me formulën $I = \frac{q}{t} \Rightarrow q = I \cdot t$ dhe gjejmë $q=240C$.

Zbatojmë ligjin e Xhaul-Lencit dhe gjejmë nxehësinë e çliruar në përcjellës: $Q = I^2 \cdot R \cdot t$ dhe gjejmë $Q=4800J$

2 pikë Nëse nxënësi gjen ngarkesën që kalon në sipërfaqen e prerjes tërthore të përcjellësit dhe nxehësinë e çliruar në përcjellës.

1 pikë Nëse nxënësi gjen ngarkesën që kalon në sipërfaqen e prerjes tërthore të përcjellësit **OSE** nxehësinë e çliruar në përcjellës.

0 pikë Nëse nxënësi e ka zgjidhur në mënyrë të gabuar **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen.

Pyetja 30**4 pikë****Përgjigje:**

Përcaktojmë rezistencën ekuivalente në qark duke ditur se R_2 dhe R_3 janë në paralel gjejmë $R_{23}=20\Omega$. Meqenëse R_{23} në seri me R_1 gjejmë $R_e=40\Omega$.

Zbatojmë ligjin e Omit përfshirë qarkut $I_p = \frac{\varepsilon}{R_e} = 0.9A$

Përcaktojmë rrymën në rezistencën R_1 : $I_1=I_p=0.9A$ dhe me ligjin e Omit përfshirë një pjesë të qarkut gjejmë:
 $U_1=R_1 \cdot I_1=18V$

Gjejmë tensionin në rezistencën R_2 dhe R_3 ku $U_2=U_3=18V$ dhe me ligjin e Omit përfshirë një pjesë të qarkut gjejmë:

$$I_2 = \frac{U_2}{R_2} = \frac{18V}{30\Omega} = 0.6A \text{ dhe } I_3 = \frac{U_3}{R_3} = \frac{18V}{60\Omega} = 0.3A$$

4 pikë Nëse nxënësi gjen rezistencën ekuivalente, rrymën e plotë, tensionin dhe rrymën në çdo rezistencë.

3 pikë Nëse nxënësi gjen rezistencën ekuivalente, rrymën e plotë, tensionin dhe rrymën në njëren prej rezistencave **OSE** gjen rezistencën ekuivalente, rrymën e plotë dhe tensionin në çdo rezistencë **OSE** gjen rezistencën ekuivalente, rrymën e plotë dhe rrymën në çdo rezistencë.

2 pikë Nëse nxënësi gjen rezistencën ekuivalente dhe rrymën e plotë.

1 pikë Nëse nxënësi gjen rezistencën ekuivalente.

0 pikë Nëse nxënësi e ka zgjidhur në mënyrë të gabuar **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen.

Pyetja 31**2 pikë****Përgjigje:**

$$\text{Zbatojmë ligjin e Faradeit: } \varepsilon_{in} = -N \frac{\Delta\Phi}{\Delta t} \quad (1)$$

Njeħsojmë $\Delta\Phi = S \cdot \cos \alpha \cdot (B_2 - B_1)$ ku $\alpha = 0^\circ$ dhe gjejmë $\Delta\Phi = 0.016 \text{ Wb}$

Zevendësojmë tek (1) dhe gjejmë $\varepsilon_{in} = 4 \text{ V}$

2 pikë

Nëse nxënësi gjen ndryshimin e fluksit dhe f.m.e. të induktuar **OSE** f.m.e. të induktuar.

1 pikë

Nëse nxënësi gjen ndryshimin e fluksit .

0 pikë

Nëse nxënësi e ka zgjidhur në mënyrë të gabuar **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen.

Pyetja 32**2 pikë****Përgjigje:**

Zbatojmë formulën $F_L = q \cdot v \cdot B \cdot \sin \alpha$ ku dallojmë që $\alpha = 90^\circ$ meqenëse elektroni hyn pingul me vijat e induksionit të fushës magnetike dhe gjejmë $F_L = 0.4 \cdot 10^{-12} \text{ N}$.

$$\text{Trejgmë që } F_L = F_{qs} \text{ pra, } q \cdot v \cdot B \cdot \sin \alpha = \frac{m \cdot v^2}{r} \text{ dhe gjejmë } r = 22.5 \cdot 10^{-5} \text{ m}$$

2 pikë

Nëse nxënësi gjen forcën e Lorencit dhe rrezen e trajektores.

1 pikë

Nëse nxënësi gjen forcën e Lorencit **OSE** rrezen e trajektores.

0 pikë

Nëse nxënësi e ka zgjidhur në mënyrë të gabuar **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen.

Pyetja 33**3 pikë****Përgjigje:**

$$\text{Gjejmë frekuencën këndore me formulën } \omega = \frac{2\pi}{T} = 4\pi \text{ rad/s.}$$

Kur layjerrësi kalon në pozicion e ekuilibrit ka shpejtësi maksimale : $v_{max} = A \cdot \omega$ dhe gjejmë: $v_{max} = 0.628 \text{ m/s}$.

Shkruajmë ekuacionin e zhvendosjes: $x = 0.05 \cos 4\pi t \text{ (m)}$.

3 pikë

Nëse nxënësi gjen frekuencën këndore, shpejtësinë në pozicionin e ekuilibrit dhe shkruan ekuacionin e zhvendosjes.

2 pikë

Nëse nxënësi gjen frekuencën këndore dhe shpejtësinë në pozicionin e ekuilibrit **OSE** gjen frekuencën këndore dhe shkruan ekuacionin e zhvendosjes **OSE** gjen shpejtësinë në pozicionin e ekuilibrit dhe shkruan ekuacionin e zhvendosjes.

1 pikë

Nëse nxënësi gjen frekuencën këndore **OSE** shpejtësinë në pozicionin e ekuilibrit **OSE** shkruan ekuacionin e zhvendosjes.

0 pikë

Nëse nxënësi e ka zgjidhur në mënyrë të gabuar **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen.

Pyetja 34**2 pikë****Përgjigje:**

Identifikojmë nga figura numrin e valëve $n=3$ dhe gjemjë gjatësinë e valës $\lambda = \frac{0.15m}{3} = 0.05m$.

Zbatojmë formulën $v = \frac{d}{t} = \frac{0.15m}{5s}$ dhe gjemjë shpejtësinë e valës $v=0.03m/s$.

Zbatojmë ekuacionin e valës $v=\lambda \cdot f$ dhe gjemjë frekuencën $f=0.6Hz$.

2 pikë

Nëse nxënësi gjen gjatësinë e valës, shpejtësinë e valës dhe frekuencën e saj.

1 pikë

Nëse nxënësi gjen gjatësinë e valës **OSE** shpejtësinë e valës .

0 pikë

Nëse nxënësi e ka zgjidhur në mënyrë të gabuar **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen.

Pyetja 35**2 pikë****Përgjigje:**

Identifikojmë nga figura këndin e rënies $\alpha=20^0$ dhe këndin e përthyerjes $\beta=13^0$.

Zbatojmë ligjin e përthyerjes së dritës për kalimin ajër-mjedis: $n_1 \cdot \sin\alpha = n_2 \cdot \sin\beta$ dhe gjemjë: $n_2 = 1.5$.

Përdorim formulën për treguesin e thyerjes : $n = \frac{c}{v} \Rightarrow v = \frac{c}{n}$ dhe gjemjë shpejtësinë e përhapjes së dritës në mjedisin transparent $v=2 \cdot 10^8 m/s$.

2 pikë

Nëse nxënësi gjen treguesin e përthyerjes për mjedisin transparent dhe shpejtësinë e përhapjes së dritës në këtë mjedis.

1 pikë

Nëse nxënësi gjen treguesin e përthyerjes për mjedisin transparent **OSE** shpejtësinë e përhapjes së dritës në këtë mjedis.

0 pikë

Nëse nxënësi e ka zgjidhur në mënyrë të gabuar **OSE** nuk ka shkruar fare në hapësirën e caktuar në dispozicion për zgjidhjen.
